



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

*Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut*

## **PROCESVERBAL**

Tiranë, më 23.10.2018, ora 10:00

**Drejton mbledhjen:**

**Ulsi Manja – kryetar i Komisionit**

### **Rendi i ditës:**

Seancë dëgjimore me kandidaturat për vendin vakant të anëtarit të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit: Besim Ndrejoni, Ermira Shtino, Gjergj Marku, Nevila Nika, Pëllumb Gjuta, Selami Zalli, Skënder Vrioni dhe Ulusi Bici.

### **Marrin pjesë:**

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina.

### **Mungojnë:**

Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Silva Caka, Astrit Veliaj dhe Tom Doshi.

## HAPET MBLEDHJA

**Ulsi Manja** – Të hyjnë mediet!

Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme.

Kuorumi është i pranishëm.

Sot kemi një çështje në rendin e ditës: Seancë dëgjimore me kandidaturat për vendin vakant të anëtarit të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Komisioni ynë është komision përgjegjës. Relatore janë koleget Klotilda Bushka dhe Vasilika Hysi.

Janë paraqitur 8 kandidatë. Përpara se të fillojmë me seancën dëgjimore dua të sjell në vëmendjen e kolegëve se vendi vakant i krijuar është për shkak të dorëheqjes së zotit Daut Gumeni nga detyra e anëtarit të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, propozim i Shoqatës së të Përndjekurve Politikë, që do të thotë se edhe kandidaturat që janë prezent në këtë seancë dëgjimore janë propozim i Shoqatës së të Përndjekurve Politikë.

Kërkoj mirëkuptimin e kolegëve, nëse 3 minuta janë të mjaftueshme për kandidatët. Dakord. Pra, 3 minuta janë të mjaftueshme.

Sipas rendit alfabetik, fillojmë me kandidatin e parë në garë, zotin Besim Ndregjoni.

Mirë se keni ardhur në Komisionin e Ligjeve!

Dokumentacioni juaj është i plotë. Sigurisht që për secilin nga kandidatët është shprehur edhe Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe DSIK-ja. Pra, kandidatët që sot kemi në këtë seancë dëgjimore janë të certifikuar nga këto dy organe shtetërore.

Zoti Ndregjoni, ju lutem, në një hark kohor prej 3 minutash, na thoni arsyet që ju shtyn të jeni pjesë e garës për të qenë anëtar i këtij autoriteti.

Fjala është për ju.

**Besim Ndregjoni** – Faleminderit!

I nderur zoti kryetar,

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ligjeve të parlamentit shqiptar,

Ndihem i privilegjuar që pas 28 vjetësh paraqes një kandidaturë në një institucion të lartë shtetëror për të cilin besoj se kam kontributet e mia 28-vjeçare në mbrojtjen, të drejtat dhe liritë e të përndjekurve politikë. Unë i përkas atij brezi të vuajtur të Shqipërisë së diktaturës së proletariatit ku vlera e njeriut ishte e papërfillshme dhe konstituohet nga Kushtetuta, diktatura e pakicës mbi shumicën.

Vij nga një familje fisnike kombëtare, e përndjekur politikisht, e cila ka dhënë kontributet e veta në çështjet kombëtare, kur kombi ka pasur nevojë. Baba im ka qenë antifashist, ka luftuar me 7 prill të '39-ës në Durrës, ka qenë humanist, që ka shpëtuar një familje hebrenjsh dhe për të gjitha këto është kundërshtar i regjimit komunist dhe është dënuar me 17 vjet burg politik, por për kontributet e tij, shteti shqiptar, pas pluralizmit e ka nderuar me Medaljen e Artë të Shqiponjës si pjesëmarrës në luftën e 7 prillit të vitit 1939. Në vitin 2007 këshilli bashkiak i ka vënë emrin një rruge në Tiranë, si nderim për mbrojtjen e hebrenjve.

Unë vij nga kjo familje dhe si rrjedhojë gjatë kohës së regjimit më janë privuar të drejtat dhe liritë themelore, e drejta e arsimimit dhe e punësimit, dhe më një vendim të komitetit ekzekutiv të Dibrës jam caktuar të punoj vetëm në tunel. Pas rënies së komunizmit jam marrë për 28 vjet vetëm me të drejtat dhe liritë e të përndjekurve politikë. Kam punuar rreth kësaj teme. Nuk kam qenë pjesë e politikëbërjes, por kanë qenë në mbrojtje të këtyre të drejtave, të cilat, fatmirësisht, me kontributin tim janë bërë disa rezoluta, janë hapur dhe një ndër kontributet kryesore është se e kam bindur parlamentin shqiptar që t'i bashkohet asamblesë parlamentare të Këshillit të Europës për dënimin e krimeve të komunizmit.

Kam punuar inspektor në Ministrinë e Punës, '91-'92. Në periudhën '92-'94 kam qenë shefi i Kabinetit Kombëtar të të Përndjekurve Politikë. Kam dhënë dorëheqjen për arsye se qeveria e zoti Meksi përdori dhunë ndaj grevës së të burgosurve politikë.

Në vitin 1998 jam propozuar nga Shoqata e të Përndjekurve Polikë si nëndrejtori i Institutit, në vitin 2000 jam emëruar drejtori i Institutit nga Kryeministri Majko, në vitin 2001 kam dhënë dorëheqjen nga ajo detyrë për arsye të çështjes së dëmshpërblimeve. Kam kontrollin e figurës edhe nga Komisioni i Pastërtisë së Figurës që në vitin 1996. Jam munduar të punoj me një ndërgjegje të pastër.

Këtu kandidova sepse duke parë qëpas 27 vjetësh parlamenti shqiptar ndërtoi një institucion që shërben për dokumentimin e krimeve të komunizmit, me dokumentimin e krimeve të Sigurimit të Shtetit. Unë kandidoj, gjithashtu, për arsye se kam një eksperiencë shumë të pasur edhe me vendet e huaja. Kam qenë në shumë seminare në Gjermani, në Amerikë, në Belgjikë dhe gjatë gjithë kësaj periudhe 28-vjeçare jam munduar që t'i mbroj këto të drejta dhe këto liri të njeriut sidomos në fushën e përndjekjes politike. Shteti shqiptar më ka nderuar me titullin “Mjeshtër i madh”, gjithashtu OKB-ja më ka dhënë titullin “Ambasador i paqes” dhe qyteti i Tiranës, i Peshkopisë dhe krahina e Postribës më kanë shpallur “Qytetar nderi”, thjesht për dokumentimin e krimeve të komunizmit dhe sensibilizimin e shoqërisë shqiptare.

Me rënien finale të komunizmit, periudha e tranzicionit demokratik tregoi se e vjetra refuzon të vdesë dhe e reja demokratike nuk gjen fuqi të mjaftueshme të lindë e të forcohet. Sot, nevoja e rishqyrtimit të rrugës së të kaluarës pas 27 vjetësh është një domosdoshmëri për shoqërinë shqiptare, e para.

Ne, si të përndjekur politikë, dhe unë, si përfaqësues i tyre, si misionar i tyre prej 28 vjetësh, kam përçarur paqen në shoqërinë shqiptare dhe jo urrejtje. Një ndër elementet më domethënëse dhe më bindëse për një shoqëri postkomuniste është se aty ku përçohet paqja, urrejtja nuk ka vend. Duke mos pasur urrejtje ish-të përndjekurit politikë nuk e kanë shfaqur kurrë urrejtjen e tyre gjatë 28 vjetëve dhe mendoj se ju si komision ndani të njëjtën pikëpamje me mua se ish-të përndjekurit politikë janë qytetarët më paqedashës të këtij kombi.

Pse kërkoj të jem në Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish –Sigurimit të Shtetit? Me studimet që kam bërë, me një publicistikë të madhe që kam paraqitur gjatë 28 vjetëve, kam shkuar në disa vende të Europës ku ka sunduar sistemi komunist, eksperiencia ime, mendoj se do t'i i jap një shtytje më të madhe për vlerat që duhet të ketë ai institucion, si dhe do t'i shërbej atij institucioni. Ne si shoqëri duhet të mësohemi të ndërtojmë raporte të drejta me të vërtetën. Nëse do të ndërtojmë raporte të tilla me të vërtetën, atëherë do të kemi një shoqëri demokratike të pastër dhe pa urrejtje, pasi urrejtjen dhe konfliktin në shqiptarët e kemi vuajtur shumë gjatë periudhës diktatoriale, por edhe pas periudhës komuniste.

Më vjen shumë keq që e shtroj para jush, por institucioni i baltosjes vazhdon nga politikëbërja. Unë mendoj se duke u thënë kjo e vërtetë, duhet të ndërtojmë marrëdhënie të tjera me brezat e rinj. Nëse brezave të rinj nuk do t'u tregojmë të vërtetën dhe do të heshtim, do t'i bëjmë një dëm shumë të madh shoqërisë shqiptare. Nisur nga të gjitha këto, mendova të kandidoj.

Ju njoftoj se jam i vetmi kandidat nga shoqatat e të përndjekurve politikë, pra jam propozuar nga të gjitha shoqatat e tyre dhe asnjë shoqatë nuk ka qenë kundër meje. Këto shoqata janë bazuar në ligjin që keni nxjerrë ju si parlament, se kjo kandidaturë u takon shoqatave të përndjekurve politikë.

Ju kërkoj ndjesë, se ndoshta kalova 3- minutëshin.

Ju falënderoj që dëgjuat ekspozenë time!

Mirënjohje për kohën që më latë!

**Ulsi Manja** - Shumë faleminderit, zoti Ndregjoni, për shpjegimet para kolegëve të komisionit!

Ka pyetje nga kolegët? Nuk ka.

Zoti Ndregjoni, shumë faleminderit për prezencën në komisionin tonë!

Ditë të mbarë!

**Besim Ndregjoni** – Faleminderit!

Bëfshi ligje sa më të mira për shoqërinë!

**Ulsi Manja**- Vazhdojmë. Të thirret kandidatja tjetër, zonja Ermira Shtino.

Zonja Shtino, mirë se keni ardhur në komisionin tonë sot në këtë seancë dëgjimore!

Ju jeni një nga kandidatët në garë për të qenë anëtare e Autoritetit për Informim. Koha në dispozicionin tuaj është 3 minuta, për të shpalosur para kolegëve të komisionit, por edhe për opinionin publik arsyet që ju shtynjë të jeni pjesë e kësaj gare, pasi dokumentacioni juaj është i plotë. Lidhur me pastërtinë e figurës tuaj ka dhënë vlerësimin edhe Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit, por edhe DSIK-ja.

Fjala është për ju për të shpjeguar arsyet që ju shtynjë të bëheni pjesë e kësaj gare.

**Ermira Shtino** – Ju falënderoj, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Jam Ermira Shtino me një eksperiencë 20 - vjeçare në administratën publike dhe prej një viti e gjysmë jam sekretare e Përgjithshme pranë Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit.

Për sa i përket prejardhjes sime, vij nga një familje që ka vuajtur nga regjimi komunist. Puna, si me dëshmipërblimin për ish - të përndjekurit politikë, qoftë pranë Ministrisë së Mirëqenies Sociale me hartimin e projektligjit, tashmë ligjit, nr.45 të vitit 2015 më shtynjë të kandidoj për postin e anëtarit të mbetur vakant pranë Autoritetit për Informim. Nga përvoja gati 2 –vjeçare, mungesa e një juristi në këtë autoritet më shtyu më tepër për të kandiduar dhe për t'u bërë pjesë e tij.

Nëse keni pyetje, jam e gatshme të përgjigjem.

**Ulsi Manja** - Faleminderit, zonja Shtino!

Ka pyetje nga kolegët?

Po, zoti Fino.

**Bashkim Fino** –Faleminderit, zonja Shtino!

Ju aktualisht jeni sekretare e Përgjithshme e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit, pra jeni pjesë e këtij institucioni dhe të jeni sekretare e Përgjithshme nuk është pak, është një vend shumë i rëndësishëm. Çfarë do të jepni më shumë ju nëse Kuvendi do të miratojë kandidaturën tuaj për anëtare të këtij Autoriteti, kur ju jeni brenda këtij Autoriteti?

**Ermira Shtino**- Pesë anëtarët aktualë të autoritetit për Dosjet e ish -Sigurimit të Shtetit kanë përvoja të ndryshme, por asnjëri prej tyre nuk ka qenë jurist në profesion. Ne si

sekretariat teknik e kemi pasur disi të vështirë të arrijmë të përmbushim të gjitha detyrimet tona me votim të plotë nga ana e Autoritetit dhe sado që shumica e vendimeve kanë qenë unanime, mendoj se mund të jap më shumë duke qenë anëtare e këtij autoriteti.

**Ulsi Manja**- Faleminderit, zonja Shtino!

Ka pyetje nga kolegët e tjerë?

Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** - Faleminderit, zonja Shtino!

Unë e vlerësoj kandidaturën tuaj, që pranoni të kandidoheni dhe të dëgjoheni. Unë kam një pyetje lidhur me organizatën që ju ka propozuar. Jeni një kandidate e propozuar nga Shoqata Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës. A mendoni se kjo qendër legjitimohet për të propozuar një kandidaturë, e cila sipas ligjit, konkretisht nenit 8, pika 1, germa “c” thotë: “Përfaqësuesi duhet të propozohet nga shoqatat e të përndjekurve politikë?”

**Ermira Shtino** - Mendimi im është se Qendra për Viktimat e Traumës dhe të Torturës e mbulon plotësisht dhe e përfaqëson veten për të më propozuar mua si anëtare, pasi ka një eksperiencë pothuajse 20 - vjeçare që merret me atë që ish- të përndjekurit kanë kaluar gjatë regjimit komunist. Duke pasur mision pothuajse të përbashkët, pasi edhe Autoriteti në punën e tij mbledh dëshmi gojore nga viktimat e regjimit komunist, besoj se e plotëson tërësisht këtë veçanti.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Shtino!

Ka pyetje të tjera nga kolegët? Po, zoti Braho.

**Spartak Braho** – Ju jeni sekretare e Përgjithshme në atë institucion, sa kohë keni?

**Ermira Shtino** - Po, një vit e gjysmë.

**Spartak Braho** – Po zoti Gumenji, pse iku?

**Ermira Shtino** – Ju ka dorëzuar një kërkesë për dorëheqje, me sa di unë.

**Spartak Braho** - Shikoni, se kryetaren atje nuk e keni shumë në rregull.

**Ermira Shtino** - Atë e vlerësoni ju, zoti deputet.

**Ulsi Manja** – Ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Shumë faleminderit, zonja Shtino!

Ditë mbarë!

**Ermira Shtino** - Shumë faleminderit që më dëgjuat!

**Ulsi Manja** - Të vijë kandidati tjetër, Gjergj Marku.

Përshëndetje, zoti Marku!

Edhe për ju është shprehur Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe DSIK-ja lidhur me pastërtinë e figurës. Jeni njëri nga kandidatët në

garë për vendin vakant në këtë autoritet. Do t'ju lutesha që, shkurtimisht, në një hark kohor prej rreth tre minutash, kohë kjo e përcaktuar për secilin nga kandidatët, të shpjegoni para kolegëve, po edhe përpara opinionit, arsyet që ju shtyjnë për të qenë pjesë e kësaj gare te Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Fjala është për ju.

**Gjergj Marku** – Faleminderit!

Unë quhem Gjergj Marku. Vi nga Mirdita. Kam mbaruar Fakultetin e Drejtësisë pas viteve '90. Kam kryer edhe një master shkencor për të drejtën publike. Vazhdoj të punoj me doktoraturën, gjithnjë lidhur me të drejtën publike kushtetuese administrative.

Arsyet që më shtyjnë për të qenë kandidat në Autoritetin Kombëtar të Hapjes së Dosjeve, është fakti se unë rrjedh nga një familje e persekutuar politikisht. Xhaxhai im Ndreçë Marku është pushkatuar në Qafën e Valmirit, më 1949. E gjithë familja ime është dënuar me internim. Unë kam qenë mbështetës i kësaj shoqate që nga fillimet e saj e deri më sot. Jam nënkryetar i shoqatës kombëtare për tre mandate. Kam mbështetje nga katër shoqata për të qenë kandidat pranë këtij autoriteti. Natyrisht, duke parë edhe ligjin 45/2015, në lidhje me raportet dhe kërkesat që ka ligji për të qenë anëtar, kërkoj besimin tuaj për të qenë anëtar i këtij komisioni.

**Ulsi Manja** – Shumë faleminderit, zoti Marku!

Ka pyetje nga kolegët?

Po, zonja Hysi!

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti Marku, që aplikuat për këtë pozicion, për këtë autoritet, që është shumë i rëndësishëm, e që duke qenë përfaqësues i një shtrese që ka vuajtur në sistemin e kaluar, dëshironi të kontribuoni.

Shoh CV-në tuaj, dhe vërej se është një CV shumë e pasur jo vetëm në fushën e drejtësisë, por edhe në fushën ku ju punoni, atë të ujërave, me specializime, kualifikime, dhe karriera juaj ka ardhur gjithnjë në rritje.

Cila është arsyeja që dëshironi ta ndërprisni këtë karrierë në fushën e ujërave e të tjera, për të kaluar në këtë fushë? Cila do të ishte vlera e shtuar? Pra, pse duhet t'ju votojë Kuvendi midis të gjithë kandidatëve? Sepse të gjithë kandidatët vijnë nga shtresa e të përndjekurve politikë. Pse mendoni se jeni kandidatura më e mirë?

**Gjergj Marku** – Unë e mendoj këtë sepse kam aftësi profesionale. E para, kam dëshirën për t'i shërbyer kësaj shtrese, sepse vi nga kjo shtresë. Kjo është arsyeja që më shtyn të lë një karrierë atje dhe të synoj një karrierë këtu. Të gjitha burgjet, kampet e internimet që janë në republikë, unë i kam ndjekur në këmbë, tash njëzet e pesë vjet. Kjo ka lidhje

trashëgimore me familjarët e mi, si dhe mendoj se duke qenë në këtë funksion, gjithnjë duke zbatuar ligjin, mund t'u shërbej më mirë të burgosurve politikë, mund të vihem më mirë në dispozicion.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Marku!

Pyetje të tjera? Nuk ka.

Shumë faleminderit për prezencën tuaj në komision! Ditë të mbarë!

**Gjergj Marku** – Faleminderit prej jush!

**Ulsi Manja** – Vazhdojmë me kandidatën tjetër në garë, zonjën Nevila Nika.

Ju lutem, zini vend, zonja Nika! Mirë se erdhët në komision, në këtë sallë dëgjimore, që zhvillon sot komisioni. Jeni njëra nga kandidatët në garë për vendin vakant të krijuar te Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Edhe për zonjën Nika, është shprehur Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, si dhe DSIK-ja, lidhur me pastërtinë e figurës.

Në fakt, dokumentacionin tuaj, që është i plotë, kolegët e mi e kanë mbi tavolinë. Do t'ju lutesha që, në një hark kohor prej tre minutash, të na thoni e cilat janë arsyet që ju shtyjnë të bëheni pjesë e kësaj gare.

Fjala është për ju!

**Nevila Nika** – Faleminderit!

Përshëndetje të gjithëve!

Po i bie shkurt: arsyeja që më shtyu të aplikoja për postin vakant në autoritetin e hapjes së dosjeve të ish- Sigurimit të Shtetit, ka qenë profesioni im si historiane dhe arkiviste. Të dyja këto janë të bashkëlidhura në shërbim të këtij institucioni. Kam menduar dhe vazhdoj ta mendoj se një arsye shumë të fortë përbëjnë njohuritë e mia në sistemin arkivor dhe pasurinë, thesarin dokumentar të vendit tim. Duke pasur këtë lloj përvojë, kam menduar se mund të jem një kontribuuese e mirë e këtij autoriteti.

Pjesë tjetër është edhe mosangazhimi im në asnjë shoqatë, organizatë, OJQ, OJF apo qoftë forcë politike. Nuk kam bërë kurrë pjesë në asnjërën prej këtyre që përmenda më sipër.

Kësisoj, gjykoj se mund të jap kontribut maksimal, aq sa mundem, ndonëse e jap edhe nga jashtë, në të gjitha veprimtaritë që zhvillon ky autoritet apo institucionet e tjera, të cilat kanë nevojë për ekspertizën time.

**Ulsi Manja** – Shumë faleminderit, zonja Nika!

Ka pyetje nga kolegët? Zoti Fino ka radhën.

**Bashkim Fino** – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Nika!



Në fakt, shoh CV-në tuaj dhe mendoj se është shumë pak ajo që kërkonte, në raport me çfarë keni bërë deri më tani. Kjo është çështja juaj, por të them të drejtën, mua më vjen pak çudi që konkurroni për një vend të tillë.

Gjithsesi, unë do t'ju bëja një pyetje. Nga Shërbimet e Kuvendit kemi informacionin se ju jeni rektore në një universitet privat. Në bazë të nenit 9, pika 3 të ligjit aktual, qenia anëtare e autoritetit është e papajtueshme me çdo detyrë tjetër shtetërore apo private. Kjo do të thotë se, nëse Kuvendi ju voton për këtë pozicion, natyrisht që duhet të jepni dorëheqjen nga pozicionet e tjera.

**Nevila Nika** – Normale.

**Bashkim Fino** – Nuk e pashë këtu te materiali juaj. Mund ta kishit vënë një sqarim të tillë, që edhe unë të mos e bëja këtë pyetje, sepse jam shumë i rregullt me letrat.

Faleminderit!

**Nevila Nika** – Atëherë po ju përgjigjem.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po ju përgjigjem. Është vetëm punë 48 orësh, kështu që nuk kam pasur mundësi t'ju sillja një informacion të tillë. CV-ja ime është ajo që unë ju kam paraqitur.

**Ulsi Manja** – Gjithsesi, mund ta shprehni edhe këtu, lidhur me pyetjen që bëri kolegu Fino.

**Nevila Nika** – Kjo është arsyeja.

**Ulsi Manja** – Në rregull! Dakord!

Zonja Hysi, keni pyetje?

**Vasilika Hysi** – Në fakt, edhe unë këtë kisha.

**Ulsi Manja** – E ezauroi kolegu Fino, kështu që...

**Vasilika Hysi** – CV-ja e profesoreshës nuk ka komente. Sinqerisht, ndjehem shumë mirë që sot ju jeni në këtë seancë. Unë e vlerësoj edhe marrjen e votës në Kuvend, për shkak të rëndësisë që ka Autoriteti, si dhe përvojës suaj të gjatë, por midis pozicionit të rektores së universitetit dhe anëtarit të këtij Autoriteti, do të preferonit qenien anëtare?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Epo, e ka të 48 orëve të fundit detyrën e re.

**Nevila Nika** – Në Universitetin European të Tiranës. Zonja Hysi, unë do t'ju bëj pak edhe për të qeshur. Unë kam qenë edhe këtu në Kuvend, ku kam punuar një periudhë të shkurtër. E kam ndjerë veten shumë mirë për sa i takon trajtimin tuaj, por e kam ndjerë veten pak si jangllësh, pasi nuk ishte vendi im. Gjithnjë sa për humor: burrin e parë e kam pasur shumë të mirë, dhe për një arsye mbeta pa të; mendova se mos gjeja një burrë tjetër të mirë.

Ndonëse më trajtojnë shumë mirë dhe tashmë pozicioni i rektores ka ndryshuar pak nga ai që ishte para meje, kam shumë pak detyra. Më tepër jam honorifike. U them gjithmonë edhe atyre atje: nuk më ngjisni. Ju mund të silleni shumë mirë, por unë dua prapë burrin e parë, që do të thotë arkivin.

Ju bëra pak për të qeshur. Kështu e kam gjykuar. Pastaj jeni ju që gjykoni dhe keni të tjera arsye, por unë me këtë timen jam nisur. Zoti Braho e di më mirë pasionin tim për arkivat dhe pasurinë arkivore, e cila duhet vënë në shërbim të këtij detyrimi ligjor, që, për hir të së vërtetës, edhe pse mezi, është duke ecur mirë.

**Ulsi Manja-** Faleminderit, zonja Nika!

Vazhdojmë me kandidatin tjetër, zotin Pëllumb Xhuta.

Ju jeni një nga kandidatët në garë për vendin vakant të anëtarit të Autoritetit për Informimin mbi Dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit. Për pastërtinë e figurës suaj dy institucione, DSIK-ja dhe vetë Autoriteti. Dokumentacioni juaj është i plotë dhe është mbi tryezën e kolegëve të mi të komisionit.

Do t'ju lutesha shkurtimisht në harkun kohor të tri minutave, koha e vendosur në dispozicion për secilin kandidat, të shpjegoni arsyet që ju shtynë për të qenë pjesë e kësaj gare.

**Pëllumb Xhuta** - Unë kam lindur në Kukës dhe jam rritur në Shtyllas të Fierit. Motivi i prezencës sime është propozimi i emrit tim nga shoqata e ish-të përndjekurve politikë dhe Instituti i Integritetit, propozim të cilin e konsideroj nder.

Arsimi im i lartë është drejtësia. Mendoj se motivi imi është studimi i thellë i dokumenteve të diktaturës dhe edukimi i brezit të ardhshëm me normat e demokracisë. Ky motiv përbën një nga bazat e mia në këtë punë.

Nuk e dua atë vend pune për teka personale, por, nëse do të më jepet besimi, do të punoj për plotësuar disa kritere, të cilat i kam zbatuar në punën time kur kam punuar në atë administratë. Nuk kam punuar në sistemin e drejtësisë asnjëherë, pavarësisht se kam mbaruar për drejtësi. Kam qenë në administratë dhe sektorin privat, kryesisht atë të sigurisë.

**Ulsi Manja-** Faleminderit!

A ka pyetje nga kolegët?

**Bashkim Fino-** Zoti Xhuta, faleminderit që erdhët këtu!

Në CV-në tuaj një pjesë të mirë të kohës keni punuar në SHISH, ndërkohë që dihet pozicioni dhe fusha e punës në SHISH si dhe e Autoritetit. Si e mendoni ju këtë ndërthurje të punës suaj për një kohë të gjatë në SHISH dhe tani, nëse do ta votojë parlamenti, si anëtar i Autoritetit të Informimit mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit?

**Pëllumb Xhuta**- Unë mendoj se mund të jetë ndihmë, madje nuk shoh ndonjë përplasje. Janë institucione të sigurisë. Unë në këtë fushë kam punuar në administratë dhe nuk besoj se kanë përplasje, aq më tepër që të dyja i përkasin elementeve të sigurisë.

**Ulsi Manja**- Faleminderit, zoti Xhuta!

Vazhdojmë me kandidatin tjetër, zotin Selami Zalli.

Zoti Zalli, mirëserdhët në komision, në këtë seancë dëgjimore për vendin vakant të anëtarit të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit!

Për kandidaturën tuaj është shprehur vetë Autoriteti dhe DSIK-ja lidhur me pastërtinë e figurës. I gjithë dokumentacioni juaj është i plotë dhe është në dispozicion të kolegëve të mi.

Do t'ju lutesha shkurtimisht që në harkun kohor prej 3 minutave të na thoni arsyet që ju shtynë për të qenë pjesë e kësaj gare.

**Selami Zalli** - Nisur nga qëllimi dhe objektivi që i kam vënë vetes edhe më parë, nisur nga formimi arsimor, eksperiencia në përgjithësi dhe ajo pranë Autoritetit në një vit e gjysmë, ku kam kryer të gjithë procesin dhe ku ndihem mirë, sidomos në bashkëpunimin korrekt me shoqata të ndryshme në kuadër të aktiviteteve për edukimin qytetar dhe procesin e rishikimit dhe vlerësimit të historisë, pra nga ky këndvështrim mbi bazën e këtij dokumentacioni që bëhet publik për herën e parë, unë kandidoj për anëtar.

**Bashkim Fino**- Faleminderit!

I bëra pyetje edhe koleges që ishte më parë dhe që është sekretare e Përgjithshme. Unë nuk arrij të kuptoj, ju jeni drejtor i Drejtorisë së Informimit në këtë institucion, pyetja që kam unë është çfarë ndryshon te ju nëse Kuvendi ju voton për anëtar të këtij Autoriteti nga pozicioni që keni si drejtor drejtorie?

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Jo, jo nëse vini për çështje rroge nuk ia vlen fare që unë të bëj pyetjen dhe ju të vini këtu.

Nëse ju jeni pjesë e një institucioni, ku edhe punoni për këtë gjë dhe vendimmarrjen mund ta marrë një komision i caktuar, një autoritet i caktuar, por ju jeni pjesë e saj dhe e gjeni veten në atë punë, çfarë ju shtyn dhe çfarë ndryshon te ju në konceptin e mirë të fjalës, nëse ne ju votojmë të jeni një nga pjesëtarët e autoritetit?

**Selami Zalli** – Duke mos dashur të hyj në detaje, unë mendoj se ndryshon procesi, sepse atje je vendimmarrës, je faktor dhe ndikimi mund të bëhet edhe më i madh në vendimmarrje, zgjidhjen e problemeve dhe zgjedhjen e ekipit që punon. Unë kam kaluar në të gjitha proceset, në të cilat jo rrallë ndodh që pengohemi nga vendimmarrja. Duke qenë edhe

jurist, edhe historian të parit e problemeve në këto dy këndvështrime, mendoj se do bëhet faktor pozitiv dhe do të ndikojë në mbarëvajtjen e punës në Autoritet.

**Ulsi Manja**- Po, faleminderit!

Shto edhe faktorin tjetër, zoti Fino, që tha zoti Braho, se edhe ai është komponent shumë i rëndësishëm.

Faleminderit, zoti Zalli!

Vazhdojmë me kandidatin e radhës, zotin Skënder Vrioni.

Faleminderit, zoti Vrioni!

Edhe ju jeni njëri nga kandidatët për vendin vakant te Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit.

Për kandidaturën tuaj është shprehur vetë Autoriteti dhe DSIK-ja lidhur me pastërtinë figurës. I gjithë dokumentacioni juaj është i plotë dhe është në dispozicion të kolegëve të mi.

Do t'ju lutesha shkurtimisht që në harkun kohorë prej 3 minutave të na thoni arsyet që ju shtynë për të qenë pjesë e kësaj gare.

**Skënder Vrioni** - Faleminderit për dëgjuesën!

Unë kam lindur në Berat dhe banoj në Tiranë. Kam formimin arsimor për juridik 4-vjeçar në Universitetin e Tiranës, kam një titull avokat dhe kam bërë master shkencor-administrativ.

Pra, mbi bazën e formimit tim aktual kam qenë i punësuar në disa institucione të rëndësishme shtetërore, ndihmësgjyqtar në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, pastaj karriera ime ka vazhduar në administratën publike si jurist në Agjencinë Kombëtare të Privatizimit dhe më pas kam një eksperiencë shumëvjeçare në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ku pozicionet e mia kanë shënuar ngritje në karrierë nga përgjegjës Sektori, drejtor i Burimeve Njerëzore dhe më vonë sekretar i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kjo eksperiencë, kryesisht në organet kolegjiale, më shtyn mua të tregoj interesin tim për të qenë pjesë e anëtarësisë së Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, për arsye se kam goxha bagazh për draftimin e udhëzimeve, rregulloreve dhe të akteve nënligjore, të cilat i kam ushtruar si në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, por ajo që është më kryesorja edhe në këtë institucion, sepse kam qenë nga të parët që ka qenë pjesë e stafit të administratës publike të këtij institucioni. Së fundi, jam drejtor i Sigurisë dhe i Zhvillimit Teknologjik në Autoritetin për Informim dhe Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit dhe besoj se kjo do të jetë një vlerësim i punës sime disavjeçare dhe do t'i shërbejë më mirë funksionimit të autoritetit, i cili për mendimin tim ka mjaft nevojë për një jurist mirëfilli, për arsye edhe të anëtarësisë së autoritetit, i cili nuk ka aktualisht një jurist mirëfilli në këtë përfaqësim.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Vrioni!

A ka pyetje?

Po, zoti Fino.

**Bashkim Fino** – Do të vazhdoj të bëj të njëjtën pyetje, pavarësisht se kandidaturat janë të ndryshme. Zoti Vrioni, në CV-në tuaj thuhet se në këto momente jeni përgjegjës sektori në këtë institucion, apo drejtor?

**Skënder Vrioni** – Nga përgjegjës jam bërë drejtor.

**Bashkim Fino** – Nuk e keni në CV-në tuaj, më mirë.

**Skënder Vrioni** – CV-ja është bërë më parë...

**Bashkim Fino** – Nuk e kam në sensin e keq, nuk je përgjegjës, por je drejtor.

Çfarë shoh unë te kjo, zoti kryetar? Edhe personi që ishte më parë, i cili ishte sekretar i Përgjithshëm, në argumentin e tij tha pikërisht këtë gjë: na duhen më shumë juristë. Nëse duhen më shumë juristë në një autoritet që e vendos Kuvendi, nëse duhen juristë në strukturën që do të sjellë kryetarja, ajo mund ta sjellë dhe të kërkojë më shumë juristë për të bërë punën, por të thuash se duhen më shumë juristë dhe duhet të jesh anëtar i një autoriteti, kjo më duket jonormale. Pyetja që kam është: çfarë do të ndryshoni ju?

Ju jeni drejtor Drejtorie, po ashtu edhe ai që doli para jush ishte drejtor Drejtorie, ajo tjetra ishte sekretare e Përgjithshme. Ju punoni në këtë institucion dhe pretendoni të bëheni anëtar i Autoritetit të Informimit të Dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, në qoftë se ju miraton Kuvendi. Çfarë do të ndryshoni ju më tepër kur ju e bëni punën e përditshme atje? Të tre ju jeni juristë, vini kandidoni këtu dhe thoni të njëjtën fjalë që duhen sa më shumë juristë në Autoritetin e Vendimmarrjes. Kjo mua më duket pak absurde si argument. Çfarë ndryshon në qenien tënde se si do ta bësh ti punën nga drejtor që je tani në një anëtar të thjeshtë?

**Skënder Vrioni** – Së pari, ai institucion nuk ka asnjë jurist dhe nuk po kërkohen shumë të tillë. Pra, është një autoritet ku janë 4 anëtarë dhe nga këta asnjë nuk është jurist, prandaj fakti që aty duhet një jurist e ndihmon procesin, sepse Autoriteti është organ kolegjal dhe merr vendime, të cilat janë të shumë të rëndësishme dhe niveli i vendimeve ka një trend rritjeje në marrjen e vendimeve të Autoritetit. Këto vendime të Autoritetit është e vërtetë që përgatiten dhe bëhen draftvendime nga ana e stafit, por vendimmarrja nuk është jona. Në arsyetimin e vendimit, besoj se ata që janë juristë më kuptojnë, ka një analizë për vendimin e marrë, sepse ka edhe përgjegjësi, prandaj e quaj të rëndësishme që të jem pjesë e këtij autoriteti. Këtu nuk bëhet fjalë për pagën, pasi normalisht mendja shkon te paga, niveli i pagës me nivelin e...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Ne e gjejmë me vend të jemi pjesë e Autoritetit...

**Bashkim Fino** – Unë nuk jua përmenda fare pagën...

**Skënder Vrioni** – Unë nuk jam nga ata që dëgjojnë nga dera, nuk e kam pasur as në vogëli dhe as si familje këtë pjesën pas derës...

**Ulsi Manja** – Ju lutem, kolegë!

Shumë faleminderit zoti Vrioni!

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Skënder Vrioni** – Jo, këtu gaboheni zoti Fino, por unë nuk jam pjesë e kësaj pune..

**Ulsi Manja** – Zonja Hysi, ka një pyetje lidhur me propozimin.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti Vrioni!

Ju falënderoj që u bëtë pjesë e kësaj gare! Në fakt, të gjithë kandidatët janë juristë dhe kanë sjellë argumentet pse duhet të ketë një jurist. Unë shoh organizatën që ju ka propozuar, organizatë, të cilën e drejton i nderuari Maloku. Te qëllimi dhe objekti i veprimtarisë së shoqatës nuk del e qartë nëse kjo shoqatë është ajo që përfaqëson shtresën e ish-të përndjekurve politikë. Pse e them këtë? Pavarësisht se zoti Saimir Maloku është i përndjekur, kjo është shumë e qartë, por duke lexuar objektin dhe qëllimin e veprimtarisë së shoqatës thuhet: “Shoqata ka për mision të nderojë sakrificën për demokraci të popullit demokrat të Tiranës dhe të gjithë Shqipërisë, të kontribuojë në edukimin e brezit të ri, të bashkëpunojë me institucionet përkatëse”.

Ndërkohë ligji për autoritetet në nenin 8 të tij, pika 1, shkronja “c”, kërkon që autoriteti të ketë një anëtar, ku një përfaqësues, në këtë jemi duke zgjedhur, të jetë i propozuar nga shoqatat e ish-të përndjekurve politikë. A mendoni ju që shoqata që ju ka propozuar hyn te shoqatat që përfaqësojnë ish-të përndjekurit politikë?

**Skënder Vrioni** – Unë mendoj se po, por kryesorja është që mjafton mbiemri im që ju të merrni vesh persekutimin e familjes sime që nga ’45-a.

*(Diskutime pa mikrofon)*

Po, kjo është. Ju po vini në diskutim...

*(Diskutime pa mikrofon)*

**Vasilika Hysi** – Jam duke folur për procedurë...

**Skënder Vrioni** – Shoqata për mua është Shoqata e ish-të Përndjekurve Politikë, kam një vendim, ua kam sjellë statusin e shoqatës juristëve tuaj, ka një vendim të përcaktuar...

*(Diskutime pa mikrofon)*

Për mua është, ndërsa pjesa tjetër është gjë tjetër, por edhe morali këtu është. Unë jam me moralin që shoqata...

**Vasilika Hysi** – Zoti Vrioni, ju të gjithë vini nga shtresa e ish-të përndjekurve politikë, pa përjashtim që të shtatë, emra të nderuar, familje të nderuara, personalitete. Po ta lexoni listën të gjithë ashtu janë...

**Skënder Vrioni** – Dakord.

**Vasilika Hysi** – Unë jam relatores, prandaj doja t'ju pyesja, sepse do të bëj relacionin për procedurën.

**Skënder Vrioni** – Më vjen keq, jam plotësisht dakord.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zonja Hysi!

Faleminderit, zoti Vrioni, për prezencën në komision!

Ditë të mbarë!

**Skënder Vrioni** – Faleminderit juve!

**Ulsi Manja** – Vazhdojmë me kandidatën e fundit në listë, zoti Ulusi Bici.

Përsëritet, zoti Bici, mirë se keni ardhur në komision!

Jeni një nga kandidatët në garë për vendin vakant tek Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Edhe për ju janë shprehur dy institucione lidhur me pastërtinë e figurës, DSIK-ja dhe vetë Autoriteti. Kolegët e disponojnë dokumentacionin tuaj, ndaj do t'ju lutesha shkurtimisht në një hark kohor prej 3 minutash, të na tregoni arsyet që ju shtynë për të qenë pjesë e kësaj gare.

Fjala për ju.

**Ulusi Bici** – Arsyeja pse jam këtu është një propozim i dy shoqatave, shoqatës së të pushkatuarve dhe shoqatës së të burgosurve politikë, konkretisht kryetarët e këtyre dy shoqatave Tanush Kaso dhe Gjoç Gjoçaj. Unë e kam pranuar thjesht si një besim nga ana e tyre për të qenë pjesë e këtij kandidimi. Nuk është se kam ndonjë kuriozitet të madh, pasi për një farë kohe kam punuar në një organ të tillë, por jam thjeshtë në kuadrin e një kontributi e jo të një të interesi.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Bici!

A ka pyetje nga kolegët?

Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Faleminderit, zoti Bici!

Kam një pyetje lidhur me përvojën tuaj, sepse një nga kërkesat që ka ligji është që duhet të keni përvojë në profesion dhe ju keni thënë se që nga viti 2000 keni ushtruar profesionin e avokatit. Nga dosja që keni dorëzuar, nuk keni ndonjë vërtetim që e vërteton këtë eksperiencë.

**Ulsi Bici** – Në vitin 2000 kam mbaruar fakultetin dhe pastaj jam regjistruar si asistent pranë një avokati. Nga viti 2002 deri në vitin 2004 kam dhënë provimin e avokatisë dhe nga viti 2005 e deri më sot jam avokat i përhershëm. Nga Dhoma e Avokatisë kam marrë një vërtetim, që vërteton se kam punuar si avokat pa shkëputje, duke përfshirë edhe vitin 2015, deri në momentin aktual.

**Ulsi Manja** – Faleminderit, zoti Bici!

Mund ta dorëzoni vërtetimin te sekretaria e komisionit.

A ka pyetje të tjera? Nuk ka. Me zotin Bici e mbyllim këtë seancë dëgjimore. Sjell në vëmendjen e kolegëve që vlerësimi i kriterëve ligjore dhe i meritës për secilin nga kandidatët që kishim në seancën dëgjimore do të bëhet në mbledhjen e radhës së Komisionit të Ligjeve.

Këtu e mbyllim mbledhjen për sot.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

## **MBYLLET MBLEDHJA**